

L I G J
Nr.8450, datë 24.2.1999

**PËR PËRPUNIMIN, TRANSPORTIMIN DHE TREGTIMIN E NAFTËS, TË
GAZIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE**

*(Ndryshuar me ligjet: nr.9218, datë 8.4.2004, nr. 9574, datë 3.7.2006, nr.9595, datë 27.7.2006;
Nr.10 137, datë 11.5.2009; nr. 12/2013, datë 14.2.2013, nr. 71/2014, datë 10.7.2014, me aktin
normativ nr.5, datë 12.3.2022;¹ nr. 8, datë 25.3.2022)*

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Shteti përcakton politikën e zhvillimit të veprimtarive në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, si dhe ushtron funksionin e tij rregullator, në përputhje me nevojat e vendit, të mbrojtjes kombëtare dhe të sigurimit publik, duke respektuar parimet e ekonomisë së tregut.

Neni 1/1

Përkufizime

(Shtuar me ligjin nr. 71/2014, datë 10.7.2014)

Në këtë ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij termit e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Naftë bruto (naftë)” ka të njëjtin kuptim, sipas përkufizimit të dhënë në ligjin nr. 7746, datë 28.7.1993, “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar.
2. “Nënproduktet e naftës” janë produktet e gatshme apo gjysmë të gatshme, të përfutuara nga përpunimi i naftës bruto.
3. “GLN” është gazi i lëngshëm i naftës, si nënprodukt i naftës.
4. “Përpunim” është procesi i distilimit dhe rafinimit që përdor si lëndë të parë naftën bruto ose nënproduktet e saj, për përfutimin e produkteve përfundimtare.
5. “Rafineri” janë instalime komplekse teknologjike, përfshirë edhe kapacitetet depozituese të lëndës së parë, të gjysmëprodukteve dhe produkteve të gatshme, ku kryhet përpunimi i naftës bruto apo nënprodukteve të saj për përfutimin e nënprodukteve apo produkteve të gatshme.
6. “Impiant përpunimi” janë instalime teknologjike, ku kryhet përpunimi i nënprodukteve të naftës për përfutimin e produkteve të gatshme.
7. “Transportim” është procesi i lëvizjes së naftës bruto apo nënprodukteve të saj nga një

¹ Akti normativ nr.5, datë 12.3.2022 është miratuar me ligjin nr. 39/2022, datë 21.4.2022, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 76, datë 20 maj 2022.

vend në një tjetër nëpërmjet tubacioneve dhe mjeteve të posaçme të transportit që përshkojnë një distancë të caktuar.

8. “Transportues” është personi, fizik apo juridik, që transporton naftën dhe nënproduktet e saj me anë të mjeteve specifike të autorizuara.

9. “Depozitim i naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre” është procesi i grumbullimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre në rezervuarë të posaçëm, nëpërmjet instalimeve teknologjike.

10. “Tregtim” është procesi i shitblerjes së naftës bruto dhe i nënprodukteve të saj nga një subjekt tek tjetri.

11. “Shoqëri tregtimi me shumicë” është personi juridik që blen naftë dhe nënproduktet e saj me qëllim shitjeje tek të tretët.

12. “Shoqëri tregtimi me pakicë” është personi juridik që blen nënprodukte të naftës, me qëllim shitjeje te personat që janë konsumatorë fundorë.

13. “Rezerva e sigurisë” është sasia e naftës dhe nënprodukteve të saj, e vendosur dhe e ruajtur në vende të caktuara, e cila përdoret sipas përcaktimeve të këtij ligji.

14. “Konsumatorë të mëdhenj” janë personat juridikë që konsumojnë për nevojat e veta nënproduktet e naftës në një sasi jo më pak se 50 m³ në muaj dhe që posedojnë instalime depozitimi të këtyre produkteve.

15. “Konsumator fundor” është personi fizik apo juridik që blen produktet e gatshme për nevojat e veta.

16. “Standard i naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” është tërësia e specifikimeve teknike të miratuara nga organet përgjegjëse që përcaktojnë cilësinë e tyre fiziko-kimike.

17. “Falsifikim” është ndërhyrje në nënproduktet e naftës, duke shtuar nënprodukte të tjera nafte apo produkte të tjera të huaja që prishin standardin fillestar të tyre.

18. “Terminale bregdetare” janë komplekse instalimesh teknologjike bregdetare për import-eksportin e naftës, gazit dhe nënproduktet e tyre, duke përfshirë pontilin e ankorimit të anijeve, depozitat, sistemin e ngarkim-shkarkimit dhe sistemet e trajtimit të mbetjeve teknologjike.

Neni 2

Në zbatim të këtij ligji, ministria, që mbulon veprimtarinë e hidrokarbureve, është përfaqësuese e shtetit në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre.

Për ndjekjen dhe realizimin e dispozitave të këtij ligji, si dhe të ligjit nr.7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet” (kërkimi dhe prodhimi), me ndryshimet përkatëse, në ministri funksionon struktura përgjegjëse për veprimtarinë e hidrokarbureve.

Neni 3

Dispozitave të këtij ligji u nënshtrohen, pa asnjë dallim, të gjithë personat juridikë, publikë ose privatë, vendas apo të huaj, që kanë si objekt të veprimtarisë së tyre përpunimin, transportimin e tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre.

Përfshirë, Këshilli i Ministrave u jep personave juridikë të caktuar, disa funksione apo kompetenca që i përkasin sektorit publik dhe që lidhen me zhvillimin e veprimtarive, objekt i këtij ligji.

Neni 4

(Ndryshuar me ligjin nr.10 137, datë 11.5.2009)

Veprimtaritë e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre, të përcaktuara në këtë ligj, përfshihen në kategorinë VIII.1, të shtojcës së ligjit për licencat. Licencimi i këtyre veprimtarive bëhet sipas ligjit për licencat ose sipas dispozitave në vijim, të këtij ligji. Këshilli i Ministrave vendos për përdorimin e njërës nga këto dy mënyra, sipas ndarjes në nënkategori. Në rastin e dytë, nuk zbatohet parimi i miratimit në heshtje.

Neni 5

Ushtrimi i veprimtarive të parashikuara në këtë ligj i nënshtrohet dispozitave të legjislacionit shqiptar për mbrojtjen e mjedisit.

Neni 6

Importimi dhe eksportimi i naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre bëhet lirisht, nga dhe në cilindo shtet, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare të kësaj fushe, ku shteti ynë është palë, duke respektuar dobinë ekonomike.

Neni 7

Këshilli i Ministrave ka kompetencë liberalizimin e çmimeve të shitjes me pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit. Në situata të veçanta tregu, Këshilli i Ministrave mund të vendosë kufizime të përkohshme (çmime tavan apo dysHEME) për çmimet e shitjes me pakicë të nënprodukteve të naftës e të gazit.

Neni 8

Personat juridikë, që ushtrojnë veprimtari në përputhje me këtë ligj, janë të detyruar të paraqesin në ministri informacion për programin e zhvillimit, si dhe të dhënat periodike, që lidhen me realizimin e veprimtarisë së tyre. Lloji i të dhënave dhe informacionit, forma dhe afatet e dërgimit të tyre, nga personat juridikë, përcaktohen kjo ministri.

Ministria përgjigjet për përpunimin dhe publikimin e këtij informacioni, duke përcaktuar formën, afatet dhe mënyrën e botimit.

Neni 9

Rezerva e sigurisë

(Shtuar një paragraf në pikën 2 me ligjin nr.9218, datë 8.4.2004)

1. Për mbulimin e nevojave të konsumit kombëtar në periudha krize dhe situatash të jashtëzakonshme brenda territorit të vendit, rafineritë e naftës dhe shoqëritë e tregtimit me shumicë janë të detyruara të mbajnë rezerva sigurie. Këshilli i Ministrave përcakton kategoritë e naftës dhe të nënprodukteve të saj, për të cilat duhet mbajtur rezerva e sigurisë.

2. Rafineritë e naftës dhe shoqëritë e tregtimit me shumicë të naftës, gazit natyror dhe nënprodukteve të tyre janë të detyruara të mbajnë rezerva sigurie, të barabarta me 30 ditë mesatare shitjeje, sasi që llogaritet duke u mbështetur në të dhënat dhe rezultatet faktike të veprimtarisë së vitit të mëparshëm.

Duke filluar nga viti 2007 deri në vitin 2010 rezerva e sigurisë do të jetë e barabartë me 60 ditë mesatare shitjeje, ndërsa nga viti 2010 e në vazhdim rezerva e sigurisë do të jetë e

barabartë me 90 ditë mesatare shitjeje.

3. Sasia e rezervës së sigurisë, që detyrohet të mbajë çdo rafineri naftë dhe çdo shoqëri tregtimi me shumicë, përcaktohet sipas kriterëve të mësipërme, me urdhër të ministrit. Struktura përgjegjëse për veprimtarinë e hidrokarbureve përgjigjet për kontrollin e sasive të rezervës së sigurisë në të gjitha subjektet.

Rafineritë e naftës dhe shoqëritë e tregtimit me shumicë detyrohen të plotësojnë sasinë përkatëse të rezervës së sigurisë, brenda 9 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

4. Rafineritë e naftës, rezervën e sigurisë deri në 50 për qind të sasisë së saj, mund ta mbajnë edhe në formën e naftës bruto në rezervuarët e tyre apo në rezervuarët e shoqërive të prodhimit të naftës, me të cilat ato kanë kontrata furnizimi. Shoqëria e tregtimit me shumicë rezervën e sigurisë e mban në rezervuarët pronë të shoqërisë apo të marra në përdorim prej saj në bazë të një kontrate.

Neni 10

(Shtuar shkronja "Ç" në kategorinë III, me ligjin nr. 71/2014, datë 10.7.2014)

Në kuptim të këtij ligji, nafta, gazi natyror dhe nënproduktet e tyre klasifikohen në kategori, si vijon:

Kategoria O

A.Nafta bruto

B.Gazi natyror

Kategoria I

A.Gazi i lëngshëm

Kategoria II

A.Benzinë automjetësh

B.Benzinë mjetësh të fluturimit ajror

C.Nënprodukte të tjera, të lëngshme si: benzol, toluol, ksilol, solven, white spirit.

Kategoria III

A.Gazoil (Diezel)

B.Vajguri ndriçues

C.Lëndë djegëse për mjetët e fluturimit ajror reaktive (kerozene)

Ç. Lëndë djegëse për përdorim termik civil dhe/ose industrial.

Kategoria IV

A.Vajrat

B.Solarë

Kategoria V

A.Bitum (asfalt)

B.Mazut

KREU II

PERSONAT JURIDIKË, QË USHTROJNË VEPRIMTARI TË PËRPUNIMIT,
TRANSPORTIMIT DHE TREGTIMIT TË NAFTËS, GAZIT DHE

NËNPRODUKTEVE TË TYRE

Neni 11

(Shtuar fjalë në shkronjat “ç” e “d” me ligjin nr.9218, datë 8.4.2004, shtuar shkronja b/1, shtuar fjalë në fund të shkronjës “c” dhe ndryshuar shkronja “d” me ligjin me ligjin nr. 71/2014, datë 10.7.2014)

Personat juridikë, që i nështrohen këtij ligji, në përputhje me natyrën e veprimtarisë së ushtruar, klasifikohen si vijon:

- a) rafineri naftë, që ushtrojnë veprimtari të përpunimit të naftës bruto;
- b) naftësjiellës e gazsjiellës, që ushtrojnë veprimtarinë e transportimit të naftës bruto dhe të gazit natyror (kategoria O);
- b/1) impiante të përpunimit;
- c) shoqëritë e tregtimit me shumicë, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit me shumicë të naftës bruto, gazit dhe nënprodukteve të tyre dhe lëndëve që shërbejnë si lëndë djegëse;
- ç) stacionet e shitjes së karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve, gazit të lëngshëm dhe vajrave lubrifikante për automjete;
- d) njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë.

Neni 12

Rafineritë e naftës

(Ndryshuar pikat 2 e 4 me ligjin nr. 71/2014, datë 10.7.2014)

1. Rafineritë e naftës janë persona juridikë, të themeluara në formën e shoqërive aksionare, të cilat me marrjen e licencës së koncesionit, kryejnë veprimtari në përpunimin e naftës bruto, duke prodhuar nënprodukte të saj. Rafineritë e naftës për tregtimin e produkteve të tyre kanë të drejtë të formojnë shoqëri tregtimi me shumicë të nënprodukteve të naftës apo të zotërojnë aksione në një shoqëri të tillë. Në këto raste rafineritë e naftës duhet të respektojnë dispozitat lidhur me konkurrencën.

2. Rafineritë e naftës janë të detyruara të zbatojnë normat dhe kushtet teknike të projektit. Ndryshimet në skemën dhe kartën teknologjike të funksionimit të rafinerive bëhen vetëm me miratim të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet. Transferimi i licencës përkatëse të rafinerisë lejohet vetëm pas miratimit të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet, sipas kushteve dhe procedurës të parashikuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Rafineritë e naftës kanë të drejtë të përpunojnë naftë bruto të prodhimit të vendit ose me origjinë nga importi. Ato kanë të drejtë të realizojnë marrëveshje për furnizimin me naftë bruto me shoqëri prodhuese të naftës, me naftësjiellës, me shoqëri të tregimit me shumicë, si dhe kanë të drejtë të realizojnë marrëveshje për importimin e naftës bruto.

4. Rafineritë e naftës kanë të drejtë t'i shesin prodhimet e tyre në vend, te shoqëritë e tregtimit me shumicë e impiantet e përpunimit, si dhe t'i eksportojnë në shtete të tjera.

5. Rafinerive të naftës u ndalohet të lidhin çfarëdo marrëveshje për furnizim të drejtpërdrejtë të stacioneve të shitjes së karburanteve, të njësive të shitjes së lëndëve djegëse, të shoqërive që tregtojnë me pakicë apo shoqërive të papajisura me licencë, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

6. Rafineritë e naftës përgjigjen për markën e prodhimit dhe cilësinë e nënprodukteve të naftës të prodhuara prej tyre.

7. Rafineritë e naftës përgjigjen për respektimin e normave të përcaktuara në këtë ligj, lidhur me rezervën e sigurisë.

Neni 12/1

(Shtuar me ligjin nr.9218, datë 8.4.2004 dhe shfuqizuar me ligjin nr.9574, datë 3.7.2006 dhe shtuar me ligjin nr. 71/2014, datë 10.7.2014)

1. Impiantet e përpunimit janë persona juridikë, të krijuar sipas legjislacionit në fuqi, që ushtrojnë veprimtari në fushën e përpunimit të nënprodukteve të naftës. Ndërtimi dhe funksionimi i impianteve të përpunimit bëhet pasi ato të jenë pajisur me “Licencë përpunimi”, të lëshuar nga ministria përgjegjëse për hidrokarburet, sipas procedurave dhe kushteve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Impiantet e përpunimit e zhvillojnë veprimtarinë e shitjes së prodhimeve të tyre vetë ose nëpërmjet një shoqërie tjetër tregtimi me shumicë, vetëm pas marrjes së licencës së tregtimit, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Impiantet e përpunimit kanë të drejtë të tregtojnë prodhimet e tyre vetëm te shoqëritë e tregtimit me shumicë, shoqëritë e tregtimit me pakicë dhe konsumatorët e mëdhenj.

4. Impiantet e përpunimit përgjigjen për markën e prodhimit dhe cilësinë e produkteve që prodhojnë.

5. Subjektet zotëruese të impianteve të përpunimit kanë të drejtë të themelojnë apo të marrin pjesë në shoqëritë që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit me pakicë të prodhimeve të tyre.

Neni 13

Naftësjellësit, gazsjellësit

(Shtuar një paragraf pas pikës 2 me ligjin nr. 71/2014, datë 10.7.2014)

1. Naftësjellësit dhe gazsjellësit janë persona juridikë të themeluar si shoqëri aksionare, që, në bazë të lejes së koncesionit, kanë të drejtë të realizojnë veprimtari të importimit, eksportimit dhe transportimit me anë të instalimeve të tyre të naftës bruto dhe gazit natyror, të vendit ose të importit, deri në vendin përcaktuar të pranimit nga rafineritë e naftës ose shoqëritë e tregtimit me shumicë. Instalimet e naftësjellësve dhe gazsjellësve përfshijnë linjat (tubacionet), rezervuaret e magazinimit (stokimit) dhe pajisjet e tjera, që shërbejnë për transportimin dhe trajtimin e fluidit.

2. Ndërtimi i naftësjellësve dhe gazsjellësve për transportimin, importimin dhe eksportimin e naftës bruto dhe të gazit natyror, bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Subjektet juridike që ushtrojnë veprimtarinë e transportimit të naftës dhe nënprodukteve të saj, me naftësjellës, janë të detyruara që çdo pesë vjet të hartojnë një plan të detajuar për mirëmbajtjen e kapaciteteve ekzistuese, si dhe të bëjnë shfrytëzimin e instalimeve, në përputhje me rregullat dhe standardet teknike të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

3. Personat juridikë, që ushtrojnë veprimtari të prodhimit në vend të naftës bruto dhe të gazit natyror, kanë të drejtë të ndërtojnë instalimet përkatëse dhe të ushtrojnë veprimtari të transportimit, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet” (kërkimi dhe prodhimi).

4. Transportimi i naftës bruto dhe i gazit natyror për import a eksport realizohet nëpërmjet kontratave që sigurojnë furnizimin e vazhduar shumëvjeçar të konsumatorëve. Një kopje e këtyre kontratave, brenda 10 ditëve nga data e lidhjes së saj, depozitohet në strukturën përgjegjëse për veprimtarinë e hidrokarbureve.

Shoqëritë e tregtimit me shumicë

(Shtuar fjalë në fund të pikës 7 dhe shtuar pikat 11 e 12 me ligjin nr.9218, datë 8.4.2004, ndryshuar pika 4 me ligjin nr.9574, datë 3.7.2006, shtuar fjalë në fund të shkronjës “a”, shtuar shkronja “c” të pikës 1, shtuar një paragraf në pikën 9 e pika 13, ndryshuar pikat 5, 7 e 12 me ligjin nr. 71/2014, datë 10.7.2014)

1. Veprimtaria e tregtimit me shumicë të naftës bruto, gazit natyror dhe nënprodukteve të tyre, të vendit a të importit, ushtrohet nga shoqëritë e tregtimit me shumicë. Përfshirë nga ky rregull bëjnë:

a) personat juridikë që prodhojnë hidrokarbure në bazë të ligjit nr.7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet” (kërkimi dhe prodhimi), të cilët kanë edhe të drejtën e tregimit të prodhimit të tyre vetëm në rafineritë e naftës, eksport dhe te shoqëritë e pajisura me licencë tregtimi të kategorisë 0/A;

b) rafineritë e naftës të cilat do të tregtojnë prodhimet e tyre.

c) impiantet e përpunimit që do të tregtojnë prodhimet e tyre.

Shoqëritë e tregtimit me shumicë kanë të drejtë ta ushtrojnë veprimtarinë e tyre në të gjithë ose në një pjesë të territorit të vendit. Këto shoqëri disponojnë impiante për depozitimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tjera dhe përgjigjen për funksionimin e këtyre impianteve, në përputhje me normat teknike të miratuara nga ministria dhe masat e Mbrojtjes Nga Zjarri (MNZ).

2. Tregtimi me shumicë i naftës, gazit dhe nënprodukteve të tjera ushtrohet vetëm nga shoqëritë tregtare, të themeluara në formën e shoqërive aksionare, pasi të jenë pajisur me leje tregtimi, sipas dispozitave të këtij ligji.

3. Shoqëritë e tregtimit me shumicë kanë të drejtë të themelojnë apo të marrin pjesë në shoqëri që ushtrojnë veprimtari si stacione të shitjes së karburanteve apo njësi të lëndëve djegëse.

4. Shoqëria e tregtimit me shumicë përgjigjet për sasinë dhe cilësinë e ngarkesës gjatë transportit.

5. Shoqëritë e tregtimit me shumicë janë të detyruara të garantojnë furnizim normal dhe jodiskriminues, në përputhje me nevojat që kanë subjektet e përcaktuara në pikën 7, me të cilët ka lidhur kontratë. Në zbatim të këtij detyrimi ato duhet të mbajnë dokumentacion të veçantë, sipas përcaktimeve të bëra nga Ministri i Financave dhe ministri përgjegjës për hidrokarburet.

6. Shoqëritë e tregtimit me shumicë e realizojnë veprimtarinë e tyre në tregun e brendshëm, si dhe eksportimin e importimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre nëpërmjet kontratës. Kryerja e pagesave për importet dhe eksportet, shlyerja e detyrimeve të tjera kontraktore, si dhe çdo detyrim doganor e fiskal, që lidhet me këto shoqëri, bëhet nëpërmjet dokumentacionit bankar.

7. Shoqëritë e tregtimit me shumicë kanë të drejtë të furnizojnë, sipas kushteve të licencës përkatëse, rafineritë e naftës, impiantet e përpunimit, shoqëritë e tregtimit me pakicë, të pajisura me licencë tregtimi, mjetet detare dhe ajrore, si dhe konsumatorët e mëdhenj.

8. Shoqëritë e tregtimit me shumicë përgjigjen për dërgimin në ministri në afatet e caktuara të informacionit të kërkuar për veprimtarinë e tyre.

9. Shoqëritë e tregtimit me shumicë përgjigjen për markën e produktit dhe cilësinë e nënprodukteve të naftës dhe gazit që tregtojnë. Ato kanë të drejtë të ushtrojnë kontroll në stacionet e shitjes së karburanteve apo në njësitë e shitjes së lëndëve djegëse të furnizuara prej tyre, me qëllim të garantimit të cilësisë së nënprodukteve të naftës dhe gazit, që u ofrohen

konsumatorëve.

Shoqëritë e tregtimit me shumicë shoqërojnë çdo produkt me certifikatë cilësie dhe mostër përfaqësuese të sekretuar, sipas kriterëve të përcaktuara nga ministri përgjegjës për hidrokarburet.

10. Shoqëritë e tregtimit me shumicë përgjigjen për respektimin e normave të përcaktuara në këtë ligj, lidhur me rezervën e sigurisë.

11. Shoqëritë aksionare të pajisura me leje tregtimi, që ndryshojnë emrin e subjektit juridik, kanë të drejtë të bëjnë shtesa ose ndryshim kategorie, brenda të njëjtit lloj lejeje, duke respektuar afatin e lejes së mëparshme dhe duke plotësuar, për secilën kategori, kushtet dhe normat teknike, të vërtetuara nga Inspektorati Qendror Teknik dhe Nënprodukteve të tyre.

12. Futja në treg dhe përdorimi i pajisjeve nën presion, që shërbejnë për trajtimin dhe ambalazhimin e gazit të lëngshëm të naftës (GLN) nga shoqëritë e tregtimit me shumicë të këtij nënprodukti, bëhet vetëm kur ato plotësojnë kushtet teknike dhe kërkesat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Shoqëritë e tregtimit me shumicë të gazit të lëngshëm të naftës përgjigjen për kryerjen e kontrollit teknik dhe mbushjen e bombolave me GLN.

Shoqëritë e tregtimit me shumicë, përpara futjes së bombolave në treg, bëjnë evidentimin e tyre për markën tregtare të shoqërisë, peshën neto, peshën bruto, vitin e prodhimit, datën e kontrollit teknik, si dhe udhëzimin për përdorim të sigurt të tyre.

13. Shoqërive të tregtimit me shumicë u ndalohet që të shesin te subjekte të tjera produkte, në të cilat është kryer falsifikim.

Neni 15

Stacionet e shitjes së karburanteve

(Ndryshuar paragrafi i parë i pikës 1 me ligjin nr.9218, datë 8.4.2004, shtuar pikat 8, 9 e 10 me ligjin nr. 71/2014, datë 10.7.2014)

1. Veprimtaria e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm për automjete dhe vajrave lubrifikante, ku përfshihen nënproduktet e kategorive I, II, III dhe IV/A, kryhet nga stacionet e shitjes së karburanteve. Me përjashtim të nënproduktit të kategorisë IV/A, nënproduktet e tjera tregtohen vetëm nëpërmjet aparateve të matjes dhe të regjistrimit të sasisë së shitjes. Stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm për automjete dhe vajrave lubrifikante ndalohen të mbushin bombola me gaz të lëngshëm për përdorim shtëpiak apo tregtar.

Stacionet e shitjes së karburanteve janë persona juridikë, që themelohen në një nga format e shoqërive të parashikuara nga legjislacioni tregtar.

Stacionet e shitjes së karburanteve lejohen të ushtrojnë veprimtarinë e tyre vetëm pasi të jenë pajisur nga organi kompetent me Licencën përkatëse, sipas këtij ligji, me kusht që ndërtimi i instalimeve dhe funksionimi i tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë të jenë në përputhje me kushtet teknike të përcaktuara nga ministria.

2. Stacionet e shitjes së karburanteve janë të detyruara të furnizohen vetëm nga shoqëritë e tregtimit me shumicë, të licencuara sipas këtij ligji, në bazë të kontratave të lidhura ndërmjet tyre.

3. Stacionet e shitjes së karburanteve, mbështetur në llojin e marrëveshjes tregtare të bashkëpunimit me shoqëritë e tregtimit me shumicë, klasifikohen si vijon:

- Stacione që furnizohen ekskluzivisht nga një shoqëri tregtimi me shumicë, të cilat janë të detyruara të mbajnë markën e saj tregtare. Këto stacione, për ekspozimin e markës së shoqërisë së tregtimit me shumicë dhe për informimin e konsumatorëve, janë të detyruara të vendosin tabela të dukshme e të dallueshme qartë nga distanca. Deri në përfundim të afatit të

marrëveshjes tregtare të bashkëpunimit ekskluziv, përkatës, këtyre stacioneve u ndalohet të furnizohen me karburante të shoqërive të tjera të tregtimit me shumicë, qoftë drejtpërdrejt ose tërthoraz;

- stacionet të quajtura të bardha, nuk kanë veprimtari të mbështetur në një marrëveshje tregtare bashkëpunimi ekskluziv me një shoqëri tregtimi me shumicë. Këto stacione kanë të drejtë të mbajnë markën e tyre të posaçme tregtare. Rregullat për mbajtjen e një marke të posaçme përcaktohen nga ministri përgjegjës për hidrokarburet. Stacioni i shitjes së karburanteve është i detyruar që, brenda 10 ditëve nga data e nënshkrimit, të depozitojë në strukturën përgjegjëse për veprimtarinë e hidrokarbureve një kopje të marrëveshjes tregtare të bashkëpunimit ekskluziv.

4. Stacioneve të shitjes së karburanteve u ndalohet të tregtojnë karburante për mjetet transporti, detar e ajror, si dhe lëndë djegëse të lëngëta apo të gazta.

5. Në çdo stacion të shitjes së karburanteve duhet të jenë të ekspozuara, në mënyrë të dukshme dhe të qartë llojet e karburanteve që tregtojnë, çmimet e tyre, koha e punës dhe shërbimet e tjera që kryhen nga stacioni.

6. Stacionet e shitjes së karburanteve përgjigjen për cilësinë e karburanteve, duke ruajtur për këtë qëllim edhe kampionet përkatëse të karburanteve, të furnizuara nga shoqëritë e tregtimit me shumicë.

7. Në çdo stacion të shitjes së karburanteve mbahet dokumentacioni, në përputhje me normat e përcaktuara nga struktura përgjegjëse për veprimtarinë e hidrokarbureve.

8. Stacioneve të shitjes së karburanteve u ndalohet që të shesin te subjekte të tjera produkte, në të cilat është kryer falsifikim.

9. Stacioneve të shitjes së karburanteve u ndalohet vendosja e markave, logove dhe sloganeve të paregjistruara paraprakisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Patentave dhe Markave, në përputhje me ligjin nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar.

10. Stacioneve të shitjes së karburanteve u ndalohet të shkruajnë emra artikujsh të ndryshëm nga ata që shesin realisht dhe të vendosura sipas standardeve të parashikuara në legjislacion në fuqi. Këto stacione duhet të vërtetojnë me dokumentacion përkatës që produkti apo shërbimi që ofrojnë i përket markës dhe standardit që reklamojnë.

Neni 16

Njësitë e lëndëve djegëse

(Ndryshuar paragrafi i parë i pikës 1 dhe shtuar pika 5 me ligjin nr.9218, datë 8.4.2004, ndryshuar paragrafi i fundit i pikës 1 dhe shtuar pika 6 me ligjin nr. 71/2014, datë 10.7.2014)

1. Veprimtaria e tregtimit me pakicë të lëndëve djegëse për ngrohje dhe gatim për konsumatorët kryhet nga stacionet dhe njësitë e lëndëve djegëse.

Njësitë e shitjes së lëndëve djegëse janë vetëm persona juridikë, të themeluar në njërin nga format e shoqërive të parashikuara nga legjislacioni shqiptar.

Njësitë e shitjes së lëndëve djegëse lejohen të ushtrojnë veprimtarinë e tyre pasi të jenë pajisur nga organi kompetent me Licencën përkatëse sipas këtij ligji.

Njësitë e shitjes së lëndëve djegëse u ndalohet të mbushin bombola gazi, të tregtojnë karburante për automjete, si dhe të ushtrojnë veprimtarinë e tyre pranë stacioneve të shitjes së karburanteve.

2. Instalimet e njësitë të lëndëve djegëse, që përfshijnë pajisjet e depozitimit dhe ato të shitjes, dhe funksionimi i këtyre njësitë duhet të jenë në përputhje me normat teknike të përcaktuara nga ministria dhe me rregullat e MNZ-së.

3. Njësitet e shitjes së lëndëve djegëse janë të detyruara që furnizimin e tyre ta bëjnë vetëm nga shoqëritë e tregtimit me shumicë, të licencuara sipas këtij ligji. Ato përgjigjen për cilësinë e produkteve që tregtojnë

4. Në njësitet e shitjes së lëndëve djegëse duhet të jenë të ekspozuar informacioni për llojet e lëndëve djegëse për ngrohje që tregtojnë, çmimet e tyre, koha e punës dhe shërbimet e tjera që kryhen nga njësia.

5. Njësitet e tregtimit me pakicë të bombolave të gazit të lëngshëm të naftës janë të detyruara të respektojnë kushtet dhe rregullat teknike për përpunimin e këtyre bombolave, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Njësive të shitjes së lëndëve djegëse u ndalohet që të shesin te subjekte të tjera produkte, në të cilat është kryer falsifikim.

KREU III

LEJA E KONCESIONIT, LEJA E TREGTIMIT, AUTORIZIMET DHE PROCEDURA E DHËNIES SË TYRE

Neni 17

(Shtuar fjalë me ligjin nr.9218, datë 8.4.2004 dhe bequr me ligjin nr.9574, datë 3.7.2006, shtuar fjalë me ligjin nr. 71/2014, datë 10.7.2014)

Personat juridikë që ushtrojnë veprimtari të përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës bruto, gazit natyror dhe nënprodukteve të tyre, përpara fillimit të ushtrimit të veprimtarisë përkatëse janë të detyruar të pajisen me licencë koncesioni, licencë përpunimi, licencë tregtimi ose autorizimi.

Neni 18

Leja e koncesionit

(Shtuar pika 3 me ligjin nr.9218, datë 8.4.2004)

1. Leja e koncesionit u jepet personave juridikë, të parashikuar në pikat “a” dhe “b” të nenit 11 të këtij ligji.

2. Leja e koncesionit jepet me vendim të Këshillit të Ministrave përpara fillimit të punimeve për ndërtimin e instalimeve, për një periudhë deri në 30 vjet me të drejtë përsëritjeje.

3. Kushtet dhe procedurat për dhënien e lejeve të koncesionit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 18/1

Licenca e përpunimit

(Shtuar me ligjin nr.9218, datë 8.4.2004 dhe shfuqizuar me ligjin nr.9574, datë 3.7.2006, shtuar me ligjin nr. 71/2014, datë 10.7.2014)

1. Licenca e përpunimit u jepet personave juridikë, të përcaktuar në shkronjën “b/1”, të nenit 11, të këtij ligji.

2. Licenca e përpunimit jepet nga ministri përgjegjës për hidrokarburet, sipas kushteve dhe procedurave të këtij ligji dhe vendimit të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

3. Licenca e përpunimit jepet për 15 vjet, me të drejtë rinovimi.

Neni 19
Leja e tregtimit

1. Licenca e tregtimit u jepet personave juridikë të parashikuar në pikën “c” të nenit 11 të këtij ligji, të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të naftës dhe gazit dhe nënprodukteve të tyre, për kategoritë përkatëse, të parashikuara në nenin 10.

2. Licencat e tregtimit ndahen në tri lloje, si vijon:

a. Licenca e tregtimit, e llojit A:

Licencë tregtimi për shoqëritë që tregtojnë produkte të kategorisë 0, II, III, IV dhe V, me përjashtim të nënprodukteve që destinohen për furnizimin e mjeteve të fluturimit ajror.

b. leja e tregtimit, e llojit B:

Licencë tregtimi për shoqëritë që tregtojnë produkte të kategorisë I (gaz i lëngshëm).

c. Licenca e tregtimit, e llojit C:

Licenca tregtimi për shoqëritë që tregtojnë karburante për mjetet e fluturimit ajror.

3. Licencë e tregtimit të llojit A, B, C jepen nga ministri përgjegjës për hidrokarburet, sipas kriterëve dhe procedurave të parashikuara në këtë ligj dhe të akteve nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tij nga Këshilli i Ministrave.

4. Licencat e tregtimit jepen me afat 10 vjet me të drejtë rinovimi.

Neni 20

Licencat

(Ndryshuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr.9218, datë 8.4.2004)

1. Licencat u jepen personave juridikë, të parashikuar në pikat “ç” dhe “d”, të nenit 11 të këtij ligji, të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre për tregtimin e karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës dhe vajrave lubrifikante për automjete (stacionet e shitjes së karburanteve) dhe për shitjen e lëndëve djegëse (njësitë e shitjes së lëndëve djegëse).

2. Licencat për personat juridikë, që ushtrojnë veprimtaritë e parashikuara në pikat “ç” dhe “d” të nenit 11, jepen nga organi i pushtetit vendor për një periudhë deri në 5 vjet me të drejtë përsëritjeje.

3. Licencat për personat juridikë, që ushtrojnë veprimtarinë e stacionit të karburanteve të ndërtuara në autostrada, jepen nga ministri përgjegjës për transportin, për një periudhë deri në 10 vjet, me të drejtë përsëritjeje.

4. Kriteret dhe procedurat për dhënien e autorizimeve përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 21

(Ndryshuar me ligjin nr.9574, datë 3.7.2006)

Personat juridikë, që paraqesin kërkesë për Licencë tregtimi, sipas nenit 19 të këtij ligji, janë të detyruar të plotësojnë kushtin e kapacitetit të depozitimit në instalimet, prona të tyre ose të marra në përdorim me kontratë, për një periudhë kohore të barabartë me atë të vlefshmërisë së Licencës së tregtimit. Kushtet e dhënies së Licencës së tregtimit përcaktohen nga Këshilli i Ministrave. Kushti i kapacitetit të depozitimit specifikohet, sipas llojit të Licencës dhe kategorisë së produkteve që tregtojnë.

KREU III/1

SITUATA E VEÇANTË DHE MASAT PËRKATËSE

(Shtuar me aktin normativ nr.5, datë 12.3.2022)

Neni 21/1
Situata e veçanta

1. Situatë e veçantë, në kuptim të këtij kreu, janë të gjitha ato situata të cilat krijojnë situatë emergjente kur tregu hidrokarbur karakterizohet nga:

a) reduktimi i përshpejtuar deri në mungesë i furnizimit me naftë, gaz dhe nënprodukte të tyre;

b) rritja e ndjeshme e çmimit të tyre në treg;

c) zvogëlimi në mënyrë të ndjeshme i importeve mesatare të naftës/gazit dhe nënprodukteve të tij, në krahasim me importet mesatare mujore të vitit kalendarik pararendës, për shkak të mungesave në tregun ndërkombëtar;

ç) zvogëlimi në mënyrë të argumentuar në një shkallë të tillë që pasojat e pafavorshme të shkaktuara nga kjo situatë nuk mund të shmangen a të parandalohen pa përcaktimin e masave në përputhje me këtë kre;

d) çdo situatë tjetër e krijuar në tregun ndërkombëtar, e cila ka sjellë deformime në tregun vendas.

2. Situata e veçantë shpallet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 21/2
Bordi

1. Në rastin e situatave të veçanta ngrihet dhe funksionon Bordi i Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe Gazit (në vijim Bordi).

2. Bordi ka në përbërje:

a) ministrin përgjegjës për ekonominë, në cilësinë e kryetarit;

b) ministrin përgjegjës për hidrokarburet;

c) Drejtorin e Përgjithshëm të Tatimeve;

ç) Drejtorin e Përgjithshëm të Doganave;

d) 5 përfaqësues nga shoqëritë e hidrokarbureve, ndër të cilët 3 përfaqësues nga shoqëritë e tregtimit me shumicë dhe 2 përfaqësues të tregtimit me pakicë të hidrokarbureve;

dh) 2 përfaqësues nga ministria përgjegjëse për hidrokarburet, në nivel drejtuesi;

e) 1 përfaqësues nga ministria përgjegjëse për financat, në nivel drejtuesi të lartë.

3. Bordi mund të ftojë të marrin pjesë në mbledhjet e tij edhe përfaqësues të tjerë nga institucione shtetërore, ekspertë të fushës apo grupe interesi.

4. Bordi merr vendime me shumicë të thjeshtë të të gjithë anëtarëve të tij. Në rastet e konfliktit të interesit të përfaqësuesve të shoqërive hidrokarbure, ndaj të cilave merret masë administrative, përfaqësuesi merr pjesë pa të drejtë vote në mbledhjen e Bordit dhe përjashtohet nga vendimmarrja.

5. Sekretariati i Bordit të përcaktuar në këtë kre do të jetë Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Fiskale, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

6. Pesë shoqëritë hidrokarbure, të cilat kanë xhiron vjetore më të lartë në vitin paraardhës, dërgojnë emrin e përfaqësuesit të tyre te Sekretariati i Bordit. Mbledhjet e Bordit thirren me kërkesë të ministrit përgjegjës për hidrokarburet dhe/ose ministrit përgjegjës për ekonominë. Njoftimi për mbledhje duhet të kryhet të paktën 2 (dy) orë para mbledhjes.

Neni 21/3

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Bordit

(Hegur togjalësh në shkronjën “c”, të nenit 21/3 me aktin normativ nr. 8, datë 25.3.2022)

Bordi ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

- a) Të zbatojë metodologjinë e përcaktuar në këtë kre për përcaktimin në transparencë të plotë të çmimit tavan, duke marrë në konsideratë një marzh, i cili mbulon kostot e shoqërisë;
- b) Të njoftojë në mënyrë periodike, sipas përcaktimit të Bordit, çmimet tavan, të cilat publikohen në Qendrën e Botimeve Zyrtare dhe në një seksion të veçantë në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet. Vendimet e marra nga Bordi i fillojnë efektet ditën pasardhëse ose sipas përcaktimit të vendimit të Bordit;
- c) Të vendosë masën administrative, sipas nenit 21/6, të këtij kreu, që duhet të ndërmerren ndaj shoqërive në rast shkeljeje të parashikimeve të këtij kreu;
- ç) Çdo kompetencë tjetër që vlerësohet e nevojshme në bazë të këtij kreu.

Neni 21/4

Strukturat për monitorimin e zbatimit të vendimeve të Bordit

Çmimet e caktuara me vendim të Bordit janë të detyrueshme të zbatohen nga të gjitha shoqëritë, sipas këtij kreu, dhe zbatimi i tyre monitorohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet verifikimit të faturave të lëshuara nga shoqëritë gjatë periudhës së masave të veçanta dhe nga Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, që vepron kryesisht nëpërmjet kontrolleve ose ankesave nga konsumatorët/qytetarët. Sipas rastit, Bordi mund të urdhërojë një nga strukturat e parashikuara në këtë nen për të kryer verifikime të thelluara në terren.

Neni 21/5

Metodologjia e llogaritjes së çmimit

(Ndryshuar me aktin normativ nr. 8, datë 25.3.2022)

Bordi cakton çdo javë ose, kur e vlerëson të nevojshëm, në diskrecion të tij, çmimin tavan për shitjen për gazoilin, benzinën dhe gazin e lëngshëm të naftës, sipas metodologjisë së mëposhtme:

- a) Çmimi i tregjeve ndërkombëtare të një dite pune më parë nga mbledhja e Bordit, të publikuara nga agjencia ndërkombëtare “S&P Global Platts” në USD, në kushtet e lëvrimit FOB Med, për gazoilin e standardit SSH EN 590 2018 dhe benzinën e standardit SSH EN 228 2018. Për rastin e GLN-së (gaz i lëngshëm i naftës) çmimi përcaktohet sipas faturës së importimit të siguruar nga shoqëritë e tregtimit me shumicë;
- b) Çmimit të përcaktuar në shkronjën “a”, të këtij neni, i shtohet një vlerë “premio” sipas faturës së importimit të siguruar nga shoqëritë e tregtimit me shumicë për gazoilin e standardit SSH EN 590 2018 dhe benzinën e standardit SSH EN 228 2018. Për gazin e lëngshëm të naftës, çmimi caktohet vetëm sipas shkronjës “a”, të këtij neni;
- c) Totali i vlerës së përfutur sipas shkronjave “a” dhe “b”, të këtij neni, konvertohet në lekë sipas kursit fiks të shpallur nga Banka e Shqipërisë një ditë më parë;
- ç) Vlerës së llogaritur në përputhje me shkronjën “c”, të këtij neni, i shtohet marzhi bruto 3 lekë/litri për shoqëritë e tregtimit me shumicë;
- d) Mbi çmimin që rezulton sipas shkronjës “ç”, të këtij neni, shtohen detyrimet doganore:
 - i. akcizë;
 - ii. taksë qarkullimi;

- iii. taksë karboni;
- iv. TVSH në import;
- v. tarifë markimi dhe skanimi;
- dh) Vlera, që rezulton sipas shkronjës “d”, të këtij neni, përbën çmimin e shitjes me shumicë, i cili publikohet;
- e) Mbi çmimin, që rezulton sipas shkronjës “dh”, të këtij neni, shtohet marzhi bruto i tregtimit me pakicë 12 lekë/litri;
- ë) Vlera, që rezulton sipas shkronjës “e”, të këtij neni, përbën çmimin i cili duhet të shpallet në tabelën e shitjes me pakicë të karburanteve.

Neni 21/6

Masat e veçanta administrative

(Ndryshuar me aktin normativ nr. 8, datë 25.3.2022)

1. Në rast të mosrespektimit të vendimit të Bordit për caktimin e çmimit tavan, ndaj shoqërive të tregtimit me shumicë dhe pakicë të produkteve të naftës dhe gazit merret masa administrative e pezullimit të licencës për 3 muaj për ushtrimin e veprimtarisë dhe detyrimin për mosndryshimin e gjendjes së produkteve të naftës dhe gazit.

2. Nëse gjatë masës së pezullimit të licencës konstatohet se subjekti ushtron veprimtarinë, merret masa administrative e heqjes së licencës për ushtrimin e veprimtarisë dhe sekuestrim të stacionit të shitjes së karburanteve.

3. Në rast se konstatohet se subjekti, pas mbarimit të masës së pezullimit dhe fillimit të veprimtarisë nuk zbaton përsëri vendimin e Bordit, merret masa administrative e heqjes së licencës për ushtrimin e veprimtarisë dhe sekuestrim të stacionit të shitjes së karburanteve.

Neni 21/7

Masat me karakter detyrues

(Shtuar pika 5 me aktin normativ nr. 8, datë 25.3.2022)

1. Të gjitha shoqëritë, që tregtojnë me shumicë produktet dhe nënproduktet e naftës dhe gazit, janë të detyruara të marrin masa për mbajtjen e rezervave përkatëse, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi, dhe të ofrojnë këtë shërbim të pandërprerë, në përputhje me vendimet e Bordit.

2. Të gjitha shoqëritë, që tregtojnë me pakicë produktet dhe nënproduktet e naftës dhe gazit, janë të detyruara të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar furnizimin e pandërprerë të konsumatorit/qtyetarit, në përputhje me vendimet e Bordit.

3. Mosmarrja e masave nga shoqëritë private, sipas përcaktimeve në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, dënohet sipas legjislacionit të fushës dhe këto shoqëri përjashtohen nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 3-vjeçare nga Agjencia e Prokurimit Publik.

4. “Albpetrol”, sh.a. me qëllim përmirësimin e situatës me furnizim të hidrokarbureve, ka të drejtë të hyjë në marrëveshje direkte me shoqëri private ose publike.

5. Të gjitha institucionet shtetërore që zhvillojnë procedura prokurimi për produktet dhe nënproduktet e naftës dhe gazit, të përcaktuara në vendimin e Bordit, duhet të mbajnë në konsideratë parashikimet e këtij ligji, si dhe vendimet e Bordit për çmimet e miratuara të produkteve dhe nënprodukteve të naftës dhe gazit, gjatë gjithë kohëzgjatjes së periudhës së veçantë.

Neni 21/8

Dhënia e masave të veçanta administrative
(Ndryshuar me aktin normativ nr. 8, datë 25.3.2022)

1. Në rast të mosrespektimit të vendimit të Bordit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, në cilësinë e organit monitorues sipas nenit 21/4, të këtij ligji, mbajnë procesverbal për shkeljen e konstatuar, i cili i dërgohet Bordit brenda 48 (dyzet e tetë) orëve.

2. Bordi merr vendim për dhënien e masës administrative sipas nenit 21/6, të këtij ligji, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e konstatimit të shkeljes.

3. Vendimi i Bordit për dhënien e masës administrative, sipas pikës 2, të këtij neni, i dërgohet për ekzekutim organit kompetent.

Neni 21/9

Vendimarrja nga Bordi

Mbledhjet e Bordit, në cilësinë e organit kolegjal gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së masave të veçanta, realizohet edhe *on-line*, nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik/telepunës.

Neni 21/10

Kohëzgjatja dhe zbatimi

1. Parashikimet e këtij kreu zbatohen për aq kohë sa zgjat periudha e situatës së veçantë.

2. Zbatimi i parashikimeve të këtij kreu fillon me shpalljen e situatës së veçantë me vendim të Këshillit të Ministrave. Përfundimi i situatës së veçantë dhe i zbatimit të parashikimeve të këtij kreu përcaktohet me vendim të Bordit.

3. Në çdo rast, ky kre nuk përjashton aplikimin e legjislacionit në fuqi për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve infektive apo akteve të tjera ligjore, për aq kohë sa nuk janë në kundërshtim me dispozitat e këtij kreu.

Neni 21/11

Ankimi ndaj masave administrative
(Ndryshuar me aktin normativ nr. 8, datë 25.3.2022)

Masat administrative të vendosura sipas këtij kreu ankimohen në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU IV

KONTROLLI MBI PERSONAT JURIDIKË, QË USHTROJNË VEPRIMTARI TË PËRPUNIMIT, TRANSPORTIMIT DHE TREGTIMIT TË NAFTËS, GAZIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE

Neni 22

Shteti organizon dhe ushtron kontroll në personat juridikë që veprojnë në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre. Drejtimit kryesorë të këtij kontrolli janë :

- Respektimi i normave teknike dhe i masave të mbrojtjes nga zjarri në instalimet, impiantet dhe pajisje që përdoren nga persona juridikë;
- respektimi i treguesve cilësorë i standardeve ligjore dhe dispozitave të tjera ligjore e nënligjore, në parandalimin e abuzimeve dhe falsifikimeve që mund të kryhen nga persona juridikë;
- respektimi i dispozitave ligjore e nënligjore, lidhur me rezultatet financiare dhe plotësimin të detyrimeve fiskale të personave juridikë ndaj shtetit.

Neni 23

Inspektorati Qendror Teknik dhe Nënprodukteve të tyre

(Ndryshuar pika 2 me ligjin nr.9218, datë 8.4.2004, shfuqizuar shkronja "c" e pikës 2 me ligjin nr. nr.9595, datë 27.7.2006; ndryshuar pika 1, paragrafi i katërt i pikës 2 dhe shtuar pika 3 me ligjin nr. 12/2013, datë 14.2.2013, ndryshuar shkronja "a" e pikës 2 me ligjin nr. 71/2014, datë 10.7.2014)

1. Organi shtetëror, i specializuar për kontrollin e veprimtarisë së personave juridikë, të ushtruar në përputhje me dispozitat e këtij ligji, është Inspektorati Shtetëror Përgjegjës, që funksionon dhe varet nga ministri përgjegjës për hidrokarburet. Ky inspektorat mbështetet në kryerjen e funksioneve të tij nga laboratorë të akredituar për fushën dhe testet përkatëse. Këta laboratorë mund të jenë pjesë e këtij inspektorati ose jashtë tij. Për çdo rast testimi, duhet të ruhet fshehtësia e mostrës.

2. a) Inspektorati shtetëror përgjegjës ka të drejtë dhe përgjigjet për:

i) kontrollin e zbatimit të normave dhe kushteve teknike në përdorimin e instalimeve, impianteve dhe pajisjeve përkatëse nga personat juridikë, që kryejnë veprimtari në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

ii) miratimin e kartave teknologjike të impianteve dhe instalimeve përkatëse;

iii) kontrollin e zbatimit të kushteve të përcaktuara në licencat përkatëse, që u janë dhënë personave juridikë, përfshirë edhe kushtet teknike për mbrojtjen nga zjarri dhe ruajtjen e mjedisit;

iv) garantimin e së drejtës për informim të publikut dhe/ose subjekteve të interesuara mbi rezultatet e analizave të kontrollit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, sipas procedurave dhe afateve të përcaktuara në ligjin nr. 8503, datë 30.6.1999, "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare". Rregullat për dhënien e informacionit për publikun dhe/ose subjektet e interesuara, miratohen nga ministri përgjegjës për hidrokarburet;

v) kontrollin e respektimit të standardeve apo rregullave shtetërore për cilësinë e naftës dhe nënprodukteve të saj;

vi) kryerjen e analizave në laboratorët e akredituar, sipas përcaktimit të pikës 1, për sasi të naftës e nënprodukteve të saj të prodhuara në vend, të importuara, para zhdoganimit, si dhe për kontrollin periodik të detyrueshëm të subjekteve që kryejnë veprimtari në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

vii) kontrollin e cilësisë së nënprodukteve të naftës te konsumatorët e mëdhenj.

Shpenzimet për kontrollin e cilësisë së naftës e nënprodukteve të saj përballohen nga vetë subjektet:

- për rastin e futjes në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- për rastin e kontrollit të cilësisë për sasi të prodhuara në vend;
- për rastin e kontrolleve periodike të detyrueshme;
- për rastin kur rezultojnë shkelje në treguesit e cilësisë.

Tarifat e kontrolleve dhe afatet e kontrolleve periodike përcaktohen nga ministri

përgjegjësi për hidrokarburet. Në rastet e tjera zbatohen rregullat e parashikuara në ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

b) Për realizimin e këtyre detyrave Inspektorati Qendror Teknik dhe Nënprodukteve të tyre bashkëpunon me organet e tjera shtetërore dhe të qeverisjes vendore, që mbulojnë fushën e ndërtimit, të rendit publik, të veprimtarisë tregtare, të mbrojtjes nga zjarri dhe të ruajtjes së mjedisit.

c) Shfuqizuar.

3. Inspektimi për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore bëhet në përputhje me këtë ligj dhe ligjin për inspektimin.

Neni 24

Kontrolli nga organet doganore dhe tatimore

(Shtuar një paragraf me ligjin nr.9218, datë 8.4.2004)

Ministria e Financave, me strukturat e saj të organeve tatimore e doganore, organizon dhe ushtron kontroll ndaj personave juridikë që i nënshtrohen këtij ligji, lidhur me respektimin e dispozitave ligjore, që lidhen me rezultatin financiar të tyre dhe plotësimin e detyrimeve fiskale e doganore ndaj shtetit, për kontrollin e treguesve cilësorë e sasiorë, si dhe të normave të tjera ligjore e nënligjore për parandalimin e abuzimeve e falsifikimeve, që nga çasti i hyrjes së mallit në pikat doganore, deri në procesin përfundimtar të shitjes së tyre.

Kontrolli i treguesve cilësorë për zhdoganimin e mallit bëhet nga Inspektorati Qendror Teknik dhe Nënprodukteve të tyre.

Neni 25

Sanksionet

(Ndryshuar pika 2 me ligjin nr.9218, datë 8.4.2004, hequr fjalë dhe ndryshuar paragrafi i fundit i pikës 1 me ligjin nr.9574, datë 3.7.2006, ndryshuar pika 1, paragrafi i dytë i nënndarjes “ii” të shkronjës “j”, pika 4, ndryshuar shifra në shkronjën “b”, shtuar pika 2.3 dhe shfuqizuar shkronja “a” e pikës 3 me ligjin nr. 12/2013, datë 14.2.2013, ndryshuar me ligjin nr. 71/2014, datë 10.7.2014)

1. Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen përkatësisht me gjobë dhe, sipas rastit, edhe me një ose disa dënime plotësuese, të përcaktuara në pikën 3 të këtij neni:

a) për shkelje të kërkesave të nenit 8, nga 100 000 deri 150 000 lekë;

b) për mosrespektim të sasisë së rezervës së sigurisë dhe të afateve të plotësimit të tyre, sipas nenit 9, deri në 50 për qind të vlerës së tregut të sasisë së produktit që mungon nga kuota e përcaktuar si rezervë sigurie;

c) për shkelje të kërkesave të nenit 12, pika 5, 2 000 000 lekë;

ç) për shkelje të kërkesave të nenit 12, pika 6, 5 000 000 lekë;

d) për shkelje të kërkesave të nenit 12/1, pika 4, nga 1 500 000 deri në 2 000 000 lekë;

dh) për tregtimin e naftës bruto të prodhuar nga shoqëritë që kryejnë veprimtari kërkimi e prodhimi, te subjekte të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 1, shkronja “a”, të nenit 14, 5 000 000 lekë;

e) për shkelje të nenit 14, pika 5, 2 000 000 lekë;

ë) për shkelje të nenit 14, pika 6, 1 000 000 deri në 1 500 000 lekë;

f) për shkelje të nenit 14, pika 7, 3 000 000 lekë;

g) për shkelje të nenit 14, pika 9, 1 500 000 deri në 2 000 000 lekë;

gj) për shkelje të nenit 14, pika 12, 300 000 deri në 500 000 lekë;

- h) për shkelje të nenit 15, pikat 2 e 3, 100 000 deri në 200 000 lekë;
- i) për shkelje të nenit 15, pika 4, 500 000 deri në 700 000 lekë;
- j) për shkelje të nenit 15, pika 6, 1 500 000 deri në 2 000 000 lekë;
- k) për shkelje të nenit 15, pika 7, 100 000 deri në 150 000 lekë;
- l) për shkelje të nenit 15, pika 9, 500 000 deri në 700 000 lekë;
- ll) për shkelje të nenit 15 pika 10, 500 000 deri në 700 000 lekë;
- m) për shkelje të nenit 16, pika 3, 300 000 deri në 500 000 lekë;
- n) për kryerjen e veprimtarive falsifikuese, sipas përcaktimeve të neneve 12/1, pika 5; 14, pika 13; 15, pika 8; dhe 16, pika 6, 10 000 000 lekë;
- nj) për mosrespektim të kushteve dhe normave teknike në instalimet dhe pajisjet:
 - i) nga 2 500 000 deri në 3 000 000, për rafineritë, impiantet e përpunimit dhe naftësjiellësit;
 - ii) nga 2 000 000 deri në 2 500 000 lekë, për instalimet dhe terminalët bregdetarë;
 - iii) nga 1 000 000 deri në 1 500 000 lekë, për shoqëritë e tregtimit me shumicë;
 - iv) nga 500 000 deri në 700 000 lekë, për stacionet e tregtimit të karburanteve dhe njësitë e shitjes të lëndëve djegëse;
- o) për ushtrimin e veprimtarisë pa licencë, konform dispozitave të këtij ligji:
 - i) nga 15 000 000 deri në 20 000 000 lekë, për rafineritë, impiantet e përpunimit dhe naftësjiellësit;
 - ii) nga 10 000 000 deri në 15 000 000 lekë, për instalimet dhe terminalët bregdetarë;
 - iii) nga 7 000 000 deri në 10 000 000 lekë, për shoqëritë e tregtimit me shumicë;
 - iv) nga 1 000 000 deri në 1 500 000 lekë, për stacionet e tregtimit me pakicë dhe njësitë e lëndëve djegëse.

2. Gjodat e parashikuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1, të këtij neni, jepen nga ministria përgjegjëse për hidrokarburet.

Gjodat e tjera jepen nga inspektorati shtetëror përgjegjës, i ngritur si strukturë e ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet.

Në rast se konstatohet mosmarrja e masave për përmirësimin e shkeljes, përsëritje e shkeljes apo kryerje e një shkeljeje tjetër të ndryshme nga shkelja e parë, masa e gjobës rritet me 50 për qind dhe, nëse subjekti gjobitet për herë të tretë, masa e gjobës dyfishohet.

3. Inspektorati shtetëror përgjegjës ka të drejtë që, paralelisht me aplikimin e gjobës, sipas parashikimeve të pikave 1 dhe 2, të këtij neni, të vendosë edhe dënimet plotësuese, si më poshtë:

- a) bllokimin e përkohshëm të veprimtarisë, por jo më shumë se 90 ditë;
- b) propozimin pranë ministrisë përgjegjëse të hidrokarbureve për fillimin e procedurave të heqjes së licencës së koncesionit, licencës së përpunimit, licencës së tregtimit me shumicë apo licencës së tregtimit me pakicë në stacionet e karburanteve apo njësitë e tregtimit të lëndëve djegëse. Ky dënim plotësues merret në rast se subjekti nuk respekton kushtin e bllokimit të përkohshëm të veprimtarisë ose përsërit shkeljen apo kryen një shkelje tjetër. Në këtë rast, vendimi për heqjen e licencës duhet të merret nga organi kompetent jo më vonë se 90 ditë nga data e konstatimit të shkeljes.

4. Inspektorati shtetëror përgjegjës, në rastet e parashikuara në pikën 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10 433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, vendos marrjen e masave urgjente, në përputhje me këtë ligj dhe ligjin për inspektimin.

5. Të ardhurat e përfituara nga gjodat e vëna kalojnë në Buxhetin e Shtetit.

6. Shqyrtimi, marrja e vendimit përfundimtar dhe ankimi ndaj vendimit të ministrisë përgjegjëse dhe inspektoratit shtetëror përgjegjës bëhen në përputhje me ligjin për inspektimin.

Ankimi ndaj vendimit të dhënë për heqjen e licencës së koncesionit, licencës së përpunimit, licencës së tregtimit me shumicë apo licencës së tregtimit me pakicë në stacionet e karburanteve

apo njësitë e tregtimit të lëndëve djegëse, sipas nënpikës 3.2, të pikës 3, të këtij neni, bëhet në gjykatë, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.

Ekzekutimi i gjobave bëhet në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”.

7. Pas kalimit të afateve të ankimit administrativ, inspektorati shtetëror përgjegjës publikon vendimin përfundimtar apo një përmbledhje të tij.

Dispozitë kalimtare

(Parashikuar me ligjin nr. 12/2013, datë 14.2.2013)

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Dispozita kalimtare

(Parashikuar me ligjin nr. 71/2014, datë 10.7.2014)

Impiantet përpunuese, të parashikuara në nenin 12/1, të cilat operojnë aktualisht në treg, janë të detyruara që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të plotësojnë kushtet përkatëse dhe të depozitojnë aplikimin pranë ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet për të përfituar licencën e përpunimit.

Neni 2

Dispozitë kalimtare

(Parashikuar me aktin normativ nr.5, datë 12.3.2022)

Me hyrjen në fuqi të këtij akti normativ shpallet edhe situata e veçantë, në kuptim të këtij kreu, dhe fillojnë të zbatohen masat me karakter të veçantë, si pasojë e situatës emergjente të tregut hidrokarbur.

Neni 26

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2326, datë 3.3.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**